

Projekti Lëvizja e Lirë e Mallrave në Kosovë

Qëllimi i projektit për përkrahje të lëvizjes së lirë të mallrave (FMG) është zhvillimi i Infrastrukturës së Cilësisë, Mbikëqyrjes së Tregut dhe të Drejtave të Konsumatorëve me qëllim të përmirësimit të proceseve të prodhimit dhe rritjes së cilësisë dhe sigurisë së produkteve dhe shërbimeve të vëna në dispozicion në tregun e brendshëm, integrimin e Kosovës në tregun e BE me eliminimin e barrierave teknike të pajustificuara në tregti dhe forcimin e pozitës së saj në tregjet e jashtme.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të mbështesë Qeverinë e Kosovës që të zhvilloj më tej kapacitetet e saj institucionale për të krijuar bazë për një mjedis të qëndrueshëm për zhvillimin e sektorit privat në përputhje me acquis të BE-së dhe kërkesat e marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Projekti FMG-se financohet nga Bashkimi Evropian. Ka filluar më 23 janar 2018 dhe do të zgjasë për 40 muaj.

Qëllimet kryesore të projektit janë:

Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe administrative të Agjencisë Kosovare të Standardizimit (AKS) në mënyrë që AKS-ja të rrisë kapacitetet e saj në fushën e rregullave teknike, vlerësimit të konformitetit dhe të rrisë numrin dhe performancën e produkteve të ofruara nga Trupat e Certifikuara me kërkesat e tyre përkatëse;

Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe administrative të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës (DAK-ut) në mënyrë që DAK-u të rrisë kapacitetet e veta në fushën e rregullave teknike dhe vlerësimit të konformitetit dhe të rrisë numrin dhe performancën e produkteve të ofruara nga OVK-te me kërkesat e tyre përkatëse;

Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe administrative të Agjencisë së Metrologjisë së Kosovës (AKM-se) në mënyrë që të ketë një infrastrukturë mirë funksionale të metrologjisë, e cila mund të mbështesë zbatimin e duhur të rregullave teknike dhe standardeve të harmonizuara me standardet e BE-së për fushën e metrologjisë;

Forcimi i Mbikëqyrjes së Tregut dhe përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional për të siguruar zbatimin e legjislacionit;

Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe administrative të Departamentit të Mbrojtjes së Konsumatorit (DMK-se) dhe rritja e përfshirjes së shoqërisë civile në mbrojtjen e konsumatorit dhe të drejtave të konsumatorit;

Rritja e vetëdijes së bizneseve dhe publikut (konsumatorët e fundit) për rolin dhe rëndësinë e Infrastrukturës së Cilësisë, pra mbi ndikimin e rregullave të detyrueshme në legjislacionin teknik dhe vlerësimin e konformitetit (duke iu referuar standardizimit, metrologjisë dhe akreditimit) lidhur me obligimet dhe të drejtat e tyre; dhe të arrijë harmonizimin substancial dhe zbatimin e legjislacionit për shtyllat e infrastrukturës së cilësisë dhe bashkëpunimin me ministrinë e linjës për legjislacionin e përbashkët.

Për me shume

informata: : E-mail:

lloncari@ibf.be

Tel/Fax: +381 (0) 38 749 898

Adresa: Ministria e Tregtisë dhe Industrisë | Rr. Muharrem Fejza, Lagjja e Spitalit, 10000, Prishtinë – Kosova.